

Njoftim i përqendrimit ndërmjet Telemah BH d.o.o. Sarajevë Bosnje dhe Hercegovina dhe T-X TV d.o.o. Tuzla, Bosnje dhe Hercegovinë

(lënda nr. 08-135/2022)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 05.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga nga shoqëria Telemah BH d.o.o. Sarajevë (Telemach BH d.o.o. Sarajevo), me seli në rrugën Jemal Bijedic nr. 216, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, mbi shoqërinë tregtare T-X TV d.o.o. Tuzla (TX TV d.o.o. Tuzla), me seli në adresën Foçanska nr. 1H, Tuzla, Bosnje dhe Hercegovinë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Telemah BH d.o.o. është tërësisht në pronësi të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimi ndërkombëtar me seli në Londër. Fondet e BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të biznesit të kompanive ku ata investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners është e pranishme dhe e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura në mënyrë indirekte:

- Total TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin VMRO nr. 3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor,

-DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Orce Nikolov 68/3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitete të marketingut, gjegjësisht me blerje dhe shitje të hapësirës reklamuese në media të shkruara dhe elektronike, dhe

UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Partizanski Odredbi nr. 14, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor.

T-X TV d.o.o. është një operator telekomunikacioni që është aktiv ekskluzivisht në Bosnje dhe Hercegovinë, përkatësisht në territorin e qyteteve Tuzla, Srebrenik, Živinice, Zavidović, Maglaja, Zenica, Sarajevë dhe Banović, duke u ofruar përdoruesve të tij shërbime të telefonisë fikse, akses në internet me brez të gjerë (kabllor dhe optik), si dhe shpërndarja e përmbajtjes mediatike.

T-X TV d.o.o nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si tregje përkatëse, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përkufizohen: **tregu i telefonisë fikse, tregu i aksesit në internet me brez të gjerë fiks dhe) tregu i shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike**, të gjitha në nivel të shitjes me pakicë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

07.10.2022

Shkup